

KLSH merr pjesë në takimin e XVI të Grupit të Punës së IT

Në datat 10-11 Tetor, u zhvillua takimi i XVI i grupit të punës së IT pranë EUROSAT-t në zyrat qendrore të NIK, Varshav, Poloni.

Ky takim, i organizuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Estonisë në bashkëpunim me Zyrën Supreme të Auditimit të Polonisë (NIK), u zhvillua në një format hibrid duke kombinuar pjesëmarrjen fizike me atë online, të rreth 50 përfaqësuesve të 20 Institucioneve Supreme të Auditimit nga e gjithë bota. Kontrolli i Lartë i Shtetit në këtë takim u përfaqësua nga znj. Ornella Çela, Drejtoreshë e Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit dhe z. Benard Haka, Kryeauditues i Departamentit të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

Takimi u hap me fjalën përshëndetëse të presidentit të NIK-ut Polak, z. Marian Banaś dhe Auditorit të Përgjithshëm të Estonisë, z. Janar Holm, i cili është edhe Kryetar i Grupit të Punës (ITWG).



Temat kryesore të diskutuara përgjatë takimit përfshinin pavarësinë në përdorimin e zgjidhjeve Cloud, sigurinë dhe vazhdimësinë e sistemeve IT. Audituesit e sektorit publik duhet të sigurohen që sistemet e përdorura nga administrata shtetërore të jenë të dizenuara dhe të mirëmbajtura siç duhet dhe se siguria e të dhënave është bërë tashmë një element i pandashëm i qeverisjes së mirë. Sovraniteti dixhital në një mjedis Cloud ishte përcaktuar si një çështje me interes të veçantë nga të gjithë SAI-et anëtare të ITWG (Grupi i Punës së IT) nisur edhe nga fakti se shumë aspekte të jetës dhe proceseve të punës së qytetarëve po aplikohen gjithnjë e më tepër në të ashtuquajturën hapësirë Cloud. Pjesëmarrësit e takimit argumentuan se sa e rëndësishme është të mos kalohet kufiri i hollë midis mbrojtjes së të dhënave dhe tejkalimit të rregulloreve në mjediset Cloud. Pjesëmarrësit patën mundësinë të njiheshin me përditësimet e reja të Manualit të Auditimit IT të prezantuar nga përfaqësuesi i SAI-t të Indisë, si dhe prezantimet e zhvilluara nga përfaqësuesit e SAI-t të Rumanisë dhe Pakistanit në lidhje me projektet dhe zhvillimet e reja në këto SAI-je mbi auditimin dhe vlerësimin e sistemeve.